

# FOL

## Performanca e sistemit prokurorial dhe gjyqësor në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2022

ANALIZË STATISTIKORE



# **Performanca e sistemit prokurorial dhe gjyqësor në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2022**

**ANALIZË STATISTIKORE**

Titulli: Performanca e sistemit prokurorial dhe gjyqësor në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2022 (analizë statistikore)

Autor: Lëvizja FOL

Viti i botimit: Maj 2023

Publikuar nga: Lëvizja FOL

Andrea Gropa nr.35 Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

info@levizjafol.org +383 (0)49 131 542

Të drejtat e autorit © 2023. Lëvizja FOL. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.

Qëndrimet e shprehura në këtë punim jo domosdoshmërisht paraqesin ato të Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL).

# Përmbajtja

<b>1. Hyrje</b> .....	<b>6</b>
<b>2. Metodologjia</b> .....	<b>8</b>
<b>3. Performanca e sistemit prokurorial në trajtimin e lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2022</b> .....	<b>9</b>
3.1 Fluksi i lëndëve.....	14
3.2 Norma e zgjidhjes së lëndëve (clearance rate).....	17
3.3 Norma e qarkullimit të lëndëve (case turnover ratio).....	20
3.4 Kohëzgjatja e zgjidhjes së lëndëve (disposition time) .....	23
3.5 Indeksi i lëndëve të grumbulluara.....	26
3.6 Mënyra e zgjidhjes së lëndëve për persona në shkallën e parë të sistemit prokurorial.....	29
<b>4. Performanca e sistemit gjyqësor në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2022</b> .....	<b>31</b>
4.1 Fluksi i lëndëve.....	36
4.2 Norma e zgjidhjes së lëndëve (clearance rate).....	39
4.3 Norma e qarkullimit të lëndëve (case turnover ratio).....	42
4.4 Kohëzgjatja e zgjidhjes së lëndëve (disposition time) .....	45
4.5 Indeksi i lëndëve të grumbulluara.....	48
4.6 Mënyra e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit nga shkalla e parë e sistemit gjyqësor .....	51
<b>5. Konkluzion</b> .....	<b>55</b>
<b>6. Rekomandime</b> .....	<b>58</b>

# 1. Hyrje

Një ndër sfidat kryesore me të cilat përballet shoqëria kosovare në përgjithësi dhe aparati shtetëror në veçanti vazhdon të mbetet perceptimi shoqëror për praninë e madhe të korrupsionit. Rrjedhimisht, metodat dhe lufta ndaj uljes së nivelit të korrupsionit doemos duhet të jenë sistematike dhe mirë të planifikuara, duke shtuar këtu harmonizimin e legjislacionin tonë kombëtar me praktikën e legjislacionit të Bashkimit Evropian. Nevoja për luftimin e korrupsionit si fenomen negativ, përveç që është domosdoshmëri, paralelisht reflekton dhe dëshirën për zhvillim dhe funksionim efikas të institucioneve shtetërore.

Prokuroria si organ bartës i hetuesisë dhe gjykata si titullar i ndarjes së drejtësisë, kanë për obligim që t'i dalin ballë detyrës së tyre në drejtim të luftimit të korrupsionit. Kësisoj, qytetaria aktive dhe një sistem i drejtësisë me predispozita për veprim efikas janë garanci për kallëzimin dhe zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit. Luftimi dhe parandalimi i kësaj dukurie negative bëhet ndërmjet bashkëveprimit institucional, të bazuar në respektimin e plotë të standardeve ligjore. Sinergjia e formuar nëpërmjet veprimit të organeve sistemit të drejtësisë, është hapi i parë i rëndësishëm dhe thelbësor drejt luftimit të korrupsionit.

Dihet se ndjekja e kryerësve të veprave penale bie në barrë të Prokurorit të Shtetit si institucion i pavarur me autoritet dhe përgjegjësi për ndjekjen penale të personave të akuzuar për ndonjë vepër penale, të rregulluar me ligj. Ky 'tagër' i sistemit prokurorial natyrisht bëhet më i rëndë, duke marrë parasysh nivelin e përhapjes së korrupsionit, fakt që përmendet edhe në konstatimet e dhëna në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2022<sup>1</sup>, ku thuhet se Kosova është në fazën e hershme të luftimit të korrupsionit. Sipas raportit, gjatë periudhës raportuese është arritur njëfarë progresi me miratimin e legjislacionit të rëndësishëm kundër korrupsionit, ndërkaq ekziston nevoja për të përmirësuar zbatimin e kornizës së përgjithshme ligjore. Nevojiten përpjekje të vazhdueshme për të zhvilluar hetime më proaktive, marrë vendime gjyqësore përfundimtare dhe bërë konfiskimin përfundimtar të pasurisë. Në fund, raporti thekson se, pavarësisht përpjekjeve tashmë të bëra, ekziston nevoja për vullnet të fuqishëm politik për të vazhduar trajtimin efektiv të rreziqeve të korrupsionit sistematik dhe kërkohet reagim i fuqishëm i drejtësisë penale ndaj korrupsionit të nivelit të lartë.

Gjykatat e të gjitha niveleve të Republikës së Kosovës, duke pasur parasysh nivelin e korrupsionit të cilin e kanë përballë, duhet që në mënyrë efikase të përballen me fluksin e lartë të rasteve të korrupsionit. Rezultati i mirë i punës së gjykatave është indikator real i seriozitetit shtetëror në luftën ndaj korrupsionit. Prandaj, efikasiteti i gjyqësorit në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit në afat të arsyeshëm dhe në mënyrë profesionale nënkupton ndikim të madh në uljen dhe parandalimin serioz të veprave penale të korrupsionit.

---

<sup>1</sup> Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën – 2022.



Sfidë tjetër brenda sistemit të drejtësisë, pra sistemit gjyqësor dhe prokurorial, na paraqitet edhe matja e kualitetit, funksionalitetit, efikasitetit, transparencës, nivelit të respektimit të standardeve organizative etj.. Analizimi i parametrave të përcaktuara shërben që të vlerësohet gjendja e kualitetit dhe efektivitetit të drejtësisë. Duke i analizuar dhe vlerësuar parametrat e tillë shenjësohen mangësitë e veprimit sistematik të organeve të drejtësisë dhe vendosen standardet gjithëpërfshirëse të forcimit të kualitetit të drejtësisë.

Duke marrë parasysh atë që u tha më lartë, të dhënat e vetme me të cilat mund të analizojmë performancën e gjykatave dhe prokurorive, janë të dhënat statistikore zyrtare të ofruara nga vet gjykatat dhe prokuroritë. Konstruktimi i rezultatit të të dhënave mbi performancën e kualitetit dhe efektivitetit të gjykatave dhe prokurorive të Republikës së Kosovës në këtë raport synohet të bëhet duke e përdorur metodologjinë e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ).

Pra, përmes të dhënave zyrtare të pranuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës, duke i gërshetuar me formulat e CEPEJ-it, do të mund të vlerësojmë punën e gjykatave dhe prokurorive mbi lëndët e korrupsionit në mënyrë specifike. Vlerësimi i tillë do të na mundësojë që të kemi parasysh fluksin e lëndëve me të cilin përballen gjykatat dhe prokuroritë gjatë një viti kalendarik, normën e arritur të zgjidhjes së lëndëve, vlerësimin e normës së qarkullimit të lëndëve, trendin e nivelizimit të lëndëve, kohëzgjatjen procedurale të trajtimit të lëndëve dhe indeksin e lëndëve të grumbulluara.

## 2. Metodologjia

Ky raport adreson çështjen e performancës dhe efikasitetit të sistemit gjyqësor dhe atij prokurorial në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit, si dhe shtjellon nivelin e ngarkesës së punës së këtyre institucioneve në zgjidhjen e këtyre lëndëve. Raporti është bazuar në të dhënat statistikore zyrtare të pranuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) për vitin 2022, ndërsa për matjen e performancës së këtyre institucioneve mbi bazën e këtyre statistikave zyrtare, FOL ka përdorur metodologjinë e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ).<sup>2</sup>

Të gjitha statistikatat e paraqitura në këtë raport përfshijnë vetëm një grup të veçantë të veprave penale, më saktësisht *Kapitullin XXXIII të Kodit Penal të Republikës së Kosovës*, që titullohet "**Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare**" dhe përfshinë nenet 414-430. Këto statistika përfshijnë vetëm veprat penale me kryerës të njohur (PP).

Efikasiteti i Prokurorisë Speciale dhe shtatë prokurorive themelore (Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Gjiilan, Ferizaj, Gjakovë) në njërin anë, dhe e shtatë gjykatave themelore të Kosovës, në anën tjetër, kanë qenë pjesë e matjes së performancës dhe e monitorimit në këtë raport. Kjo matje nuk përfshinë cilësinë e lëndëve, cilësinë e punës së prokurorive dhe gjykatave, cilësinë e shërbimit të administratës apo integritetin dhe profesionalizmin e prokurorëve dhe gjyqtarëve, por vetëm analizën numerike të tyre.

Fushat në të cilat FOL është bazuar për matjen e performancës së prokurorisë dhe gjyqësorit janë si në vazhdim: 1) *fluksi i lëndëve*, 2) *norma e zgjidhjes së lëndëve*, 3) *norma e qarkullimit të lëndëve*, 4) *kohëzgjatja e trajtimit të lëndëve*, si dhe 5) *indeksi i lëndëve të grumbulluara*.

Në pjesën e parë të raportit është matur performanca e sistemit prokurorial në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit, përmes indikatorëve të Komisionit Evropian të Efikasitetit të Drejtësisë (CEPEJ) në nivel të përgjithshëm dhe për secilën prokurori veç e veç. Ndërsa në pjesën tjetër është analizuar performanca e sistemit gjyqësor në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit përmes metodologjisë së CEPEJ, po ashtu në nivel të përgjithshëm dhe për secilën gjykatë veç e veç, si dhe numri dhe lloji i vendimeve të shqiptuara nga ana e gjykatave.

Matje të tillë nga statistikatat e prokurorisë përmes metodologjisë së CEPEJ, FOL ka bërë edhe në të kaluarën<sup>3</sup>, dhe të njëjtën do ta vazhdoj në mënyrë periodike edhe në të ardhmen.

---

<sup>2</sup> Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) është organi i Këshillit të Evropës, i cili përpiqet të përmirësojë efikasitetin dhe funksionimin e drejtësisë në shtetet anëtare dhe të zhvillojë dhe zbatojë instrumentet praktike të miratuara nga Këshilli i Evropës për këtë qëllim. Duhet theksuar se raporti i Lëvizjes FOL nuk është i autorizuar nga Këshilli i Evropës dhe se formulat, edhe pse janë identike, nuk janë zyrtare.

<sup>3</sup> Për më tepër, shih: *Performanca e Prokurorisë në Luftën Kundër Korrupsionit 2017*; *Performanca e Prokurorisë në Zgjidhjen e Lëndëve të Korrupsionit gjatë vitit 2021*.

# **3** Performanca e sistemit prokurorial në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2022











### 3. Performanca e sistemit prokurorial në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2022


Rezultati nga përlogaritja e performancës së prokurorive të Republikës së Kosovës në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit është një tregues mbi seriozitetin, vullnetin dhe vendosmërinë e sistemit prokurorial në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

Duke i analizuar përparësitë dhe shpërfaqur dobësitë në punën e prokurorive gjatë trajtimit të lëndëve të korrupsionit, do të mund të kontribuojmë në pasqyrimin e situatës së përgjithshme të luftës ndaj korrupsionit. Performanca e mirë e prokurorive në trajtimin e lëndëve të korrupsionit, pra efikasitetin në ndjekjen e personave të involvuar në këto vepra penale, nënkupton respektimin e plotë të ligjeve dhe prioriteteve të vendosura nga ana e Këshillit Prokurorial të Kosovës.


Në tabelën e mëposhtme është paraqitur pasqyra e përgjithshme me të dhëna e sistemit prokurorial, në të cilët janë bazuar këta indikatorë.

	PS Lëndë të trashëguara	I Lëndë të reja	LP Gjithsej lëndë në punë
 Prokuroria Speciale	60	57	117
 Prokuroria Themelore në Prishtinë	117	200	317
 Prokuroria Themelore në Gjilan	14	69	83
 Prokuroria Themelore në Prizren	17	68	85
 Prokuroria Themelore në Mitrovicë	105	50	155
 Prokuroria Themelore në Gjakovë	36	35	71
 Prokuroria Themelore në Pejë	25	39	64
 Prokuroria Themelore në Ferizaj	19	42	61
<b>TOTAL:</b>	<b>393</b>	<b>560</b>	<b>953</b>

**TABELA 1.** Pasqyra e përgjithshme e performancës së Sistemit Prokurorial në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2022.



Ndërsa në tekstin në vijim janë paraqitur indikatorët matës të efikasitetit të punës së Prokurorit të Shtetit (Prokurorisë Speciale dhe shtatë prokurorive themelore) në përgjithësi në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2022.



## 3.1 Fluksi i lëndëve

Pjesë e rëndësishme e rrethit të vështirësive për menaxhimin sa më efikas dhe cilësor të lëndëve nga ana e prokurorive është fluksi i madh i lëndëve. Fluksi i lëndëve është tregues bazë i ngarkesës në punë dhe përfshin lëndët e reja dhe lëndët e trashëguara nga periudhat paraprake.


Numri i lëndëve të reja nënkupton numrin e lëndëve që futen në sistem dhe që kërkojnë veprim nga ana e prokurorive, ndërsa numri i lëndëve të zgjidhura është përgjigjja që jep sistemi prokurorial, pra numri i lëndëve që janë trajtuar. Ndërkaq lëndët që priten të trajtohen janë numri i lëndëve që mbeten për t'u zgjidhur nga prokuroria në një kohë të caktuar dhe si të tilla janë lëndë që barten në vitin e ardhshëm.

Fluksi i lëndëve përmes metodologjisë së Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) shprehet përmes kësaj formule:

$$LP \text{ (lëndë në punë)} = PS \text{ (lëndë të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese)} + I \text{ (lëndë të reja)}$$


Gjatë periudhës janar – dhjetor 2022, gjithsej raste në punë në Prokurorinë Speciale dhe në shtatë prokuroritë themelore në lidhje me veprat penale të Kapitullit XXXIII të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare) kanë qenë 953 lëndë.

Në këtë numër, pra, kanë kontribuar lëndët e bartura nga viti paraparak (393 lëndë), si dhe lëndët e reja të krijuara gjatë vitit (560 lëndë). Pra, shprehur në përqindje, 41 % e lëndëve të korrupsionit të të gjitha gjykatave që ishin në punë gjatë vitit 2022 ishin të bartura nga viti paraparak, ndërsa 59 % e lëndëve ishin lëndë të reja, të krijuar gjatë vitit 2022.



Kjo shifër tregon se fluksi i lëndëve gjatë vitit 2022 në të gjitha prokuroritë themelore dhe në atë special ishte më i lartë se në vitin 2021, **ku në punë gjatë këtij viti ishin gjithsej 802 lëndë. Pra në këtë vit kishte rritje të fluksit të lëndëve të korrupsionit për 17%.**

Renditja e prokurorive sipas fluksit të lëndëve është paraqitur në tabelën e mëposhtme:



**FIGURA 2.** Renditja e gjykatave sipas fluksit të lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2022.

**Sipas tabelës së paraqitur më lartë, rezulton se me fluksin më të lartë të lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2022 është përballur:**

→ **Prokuroria Themelore e Prishtinës**, e cila gjatë kësaj periudhe në punë kishte 317 lëndë, 117 prej të cilave ishin të trashëguara nga viti paraprak, ndërsa 200 lëndë janë krijuar gjatë vitit. Kjo është prokuroria me numrin më të madh të lëndëve të reja të korrupsionit të krijuara gjatë vitit 2022, si dhe me numrin më të madh të lëndëve të bartura nga viti paraprak.

**Ndërsa me fluksin më të ulët të lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2022 është përballur:**

→ **Prokuroria Themelore e Ferizajt**, e cila në punë kishte gjithsej 61 lëndë, 18 prej të cilave ishin të trashëguara nga viti paraprak, ndërsa 42 lëndë ishin krijuar të reja.

Edhe sipas matjes së performancës së Sistemit Prokurorial në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit të bërë për vitin 2021, me fluksin më të madh të lëndëve të korrupsionit ishte përballur Prokuroria Themelore në Prishtinë (me gjithsej 245 lëndë në punë), përkatësisht 72 lëndë më pak se në vitin 2022.

Ndërsa prokuroria me fluksin më të ulët të lëndëve të korrupsionit në vitin 2021 ishte Prokuroria Themelore e Gjilanit, me gjithsej 54 lëndë në punë, apo 29 lëndë më pak se në vitin 2022.

## 3.2 Norma e zgjidhjes së lëndëve (clearance rate)

Norma e zgjidhjes së lëndëve është një indikator i rëndësishëm që mat raportin midis numrit të lëndëve të reja (I) dhe numrit të lëndëve të zgjidhura (R). Pra në kuadër të matjes, në këtë indikator nuk përfshihen numri i lëndëve të trashëguara nga viti paraprak. Si i tillë, ky indikator tregon performancën e një prokurorie të shprehur në përqindje, si dhe tregon për kapacitetin punues të prokurorive në zgjidhjen e lëndëve të reja. Norma ideale e zgjidhjes së lëndëve do të duhej të ishte 100 %, që nënkupton se sistemi zgjidh aq lëndë sa pranon gjatë vitit.

Norma e zgjidhjes së lëndëve sipas metodologjisë së Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) shprehet përmes kësaj formule:

$$\text{Norma e zgjidhjes së lëndëve \%} = \frac{\text{lëndët e zgjidhura (R)}}{\text{lëndët e reja (I)}} \times 100$$

Rrjedhimisht sipas kësaj formule, norma mesatare e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2022 në të gjitha prokuroritë themelore dhe në atë speciale është si vijon:

$$\text{Norma e zgjidhjes së lëndëve \%} = \frac{430}{560} \times 100 = 77\%$$

Pra sipas kësaj formule, numri i lëndëve të korrupsionit të zgjidhura gjatë vitit 2022 ishte 430, numri i lëndëve të reja të pranuar gjatë vitit 2022 ishte 560, norma e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2022 del të jetë 77 %. Pra numri i lëndëve të reja të pranuar gjatë vitit 2022 ishte ndjeshëm më i lartë në raport me lëndët e zgjidhura gjatë këtij viti, që nënkupton mungesë të kapaciteteve për zgjidhjen e lëndëve të reja dhe krijon ngarkesë në të ardhmen me çështje paraprake.

---

**Me fjalë të tjera, nga 953 lëndë të korrupsionit që ishin në punë gjatë vitit 2022, prokuroritë kanë arritur të zgjedhin 430 lëndë, përkatësisht 45% të lëndëve, ndërsa pjesa tjetër prej 523 lëndësh kanë mbetur të pazgjidhura dhe janë bartur për vitin 2022.**


















---

Kjo nënkupton se në raport me vitin 2021, kur norma e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit në prokuroritë e Republikës së Kosovës kishte rezultuar të jetë 84 %, ky indikator në vitin 2022 kishte pësuar rënie.

Ndërkaq norma e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit në secilën prokurori themelore dhe në atë speciale gjatë vitit 2022 është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

**PROKURORITË THEMELORE  
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
DHE PROKURORIA  
SPECIALE**

$$\text{Norma e zgjidhjes së lëndëve \%} = \frac{\text{lëndët e zgjidhura (R)}}{\text{lëndët e reja (I)}} \times 100$$

	<b>Prokuroria Speciale</b>	$\frac{51}{57} \times 100 = \mathbf{89\%}$	
	<b>Prokuroria Themelore në Prishtinë</b>	$\frac{122}{200} \times 100 = \mathbf{61\%}$	
	<b>Prokurorial Themelore në Gjilan</b>	$\frac{68}{69} \times 100 = \mathbf{99\%}$	
	<b>Prokuroria Themelore në Prizren</b>	$\frac{51}{68} \times 100 = \mathbf{75\%}$	
	<b>Prokuroria Themelore në Mitrovicë</b>	$\frac{49}{50} \times 100 = \mathbf{98\%}$	
	<b>Prokuroria Themelore në Gjakovë</b>	$\frac{24}{35} \times 100 = \mathbf{69\%}$	
	<b>Prokuroria Themelore në Pejë</b>	$\frac{37}{39} \times 100 = \mathbf{95\%}$	
	<b>Prokuroria Themelore në Ferizaj</b>	$\frac{28}{42} \times 100 = \mathbf{67\%}$	
	<b>TOTAL:</b>	$\frac{430}{560} \times 100 = \mathbf{77\%}$	

**TABELA 2.**

Norma e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2022 në shtatë prokuroritë themelore dhe në atë speciale.



**Sipas tabelës së paraqitur më lartë, rezulton se normën më të lartë të zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2022 e ka arritur:**

- **Prokuroria Themelore e Gjilanit**, e cila kishte 69 lëndë të reja të krijuara gjatë vitit, ndërsa kishte arritur të zgjidh 68 lëndë, duke arritur normën e zgjidhjes së lëndëve në 99 %;

**Ndërsa normën më të ulët të zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit e ka arritur:**

- **Prokuroria Themelore e Prishtinës**, e cila kishte 200 lëndë të reja të krijuara gjatë vitit, ndërsa kishte arritur të zgjidh 122 lëndë, duke arritur normën e zgjidhjes së lëndëve në 61 %.

Ndërkaq sipas matjes së performancës së sistemit prokurorial në luftën kundër korrupsionit të bërë për vitin 2021, normën më të lartë të zgjidhjes së lëndëve gjatë këtij viti e kishte arritur Prokuroria Themelore e Prizrenit (120 %), e cila nga 61 lëndë të reja të krijuara gjatë vitit, kishte arritur të zgjidh 73 lëndë, ndërsa normën më të ulët të zgjidhjes së lëndëve e kishte arritur Prokuroria Themelore e Gjakovës (44 %), e cila nga 43 lëndë të reja të krijuara gjatë vitit, kishte arritur të zgjidh vetëm 19 lëndë.

### 3.3 Norma e qarkullimit të lëndëve (case turnover ratio)

Norma e qarkullimit të lëndëve mat raportin mes numrit të lëndëve të zgjidhura dhe numrit të lëndëve që kanë mbetur të pazgjidhura brenda një viti. Pra kjo normë e mat frekuencën me të cilën sistemi e zëvendëson numrin e lëndëve të reja. Pra, formula e Komisionit Evropian për Matjen e Efikasitetit të Drejtësisë përdor numrin e lëndëve të zgjidhura në fund të periudhës raportuese dhe e pjesëton me numrin e lëndëve të pazgjidhura, duke nxjerrë normën e qarkullimit të lëndëve.

Me falë të tjera, norma qarkullimit të lëndëve mat se sa shpejt sistemi (në këtë rast i prokurorisë) i trajton lëndët që i pranon – që ndryshe i bie se sa shumë kohë merr sistemi për zgjedhjen e një lënde.

Norma e qarkullimit të lëndëve përmes metodologjisë së Komisionit Evropian për Matjen e Efikasitetit të Drejtësisë (CEPEJ) shprehet përmes kësaj formule:

$$\text{Norma e qarkullimit të lëndëve} = \frac{\text{Lëndët e zgjidhura (R)}}{\text{Lëndët pa zgjidhura (PE)}}$$

Rrjedhimisht nga kjo formulë, norma mesatare e qarkullimit të lëndëve në të gjitha prokuroritë themelore dhe atë speciale gjatë vitit 2022 është:

$$\text{Norma e qarkullimit të lëndëve} = \frac{430}{523} = 0.82$$


















Norma ideale e qarkullimit të lëndëve do të duhej të ishte të paktën 1, që nënkupton se sistemi zgjidh po aq lëndë sa pranon gjatë vitit dhe nuk ka bartur asnjë lëndë për vitin e ardhshëm. Ndërsa, në këtë rast norma e qarkullimit të lëndëve është pak më e madhe se 1, që nënkupton se në rastin konkret ka diferencë të vogël në raport me normën ideale të qarkullimit të lëndëve.

Norma e qarkullimit të lëndëve ka shënuar ulje në raport me vitin e kaluar (vitin 2021), ku kjo normë kishte rezultuar në 1.04.

Norma e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2022 në secilën prokurori themelore dhe në atë speciale është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

**PROKURORITË THEMELORE  
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
DHE PROKURORIA SPECIALE**

$$\text{Norma e qarkullimit të lëndëve} = \frac{\text{lëndët e zgjidhura (R)}}{\text{lëndët pa zgjidhura (PE)}}$$

	<b>Prokuroria Speciale</b>	$\frac{51}{66} = 0.77$	
	<b>Prokuroria Themelore në Prishtinë</b>	$\frac{122}{195} = 0.62$	
	<b>Prokurorial Themelore në Gjilan</b>	$\frac{68}{15} = 4.53$	
	<b>Prokuroria Themelore në Prizren</b>	$\frac{51}{34} = 1.5$	
	<b>Prokuroria Themelore në Mitrovicë</b>	$\frac{49}{106} = 0.46$	
	<b>Prokuroria Themelore në Gjakovë</b>	$\frac{24}{47} = 0.51$	
	<b>Prokuroria Themelore në Pejë</b>	$\frac{37}{27} = 1.37$	
	<b>Prokuroria Themelore në Ferizaj</b>	$\frac{28}{33} = 0.84$	
<b>TOTAL:</b>		$\frac{430}{523} = 0.82$	

**TABELA 3.**

Norma e qarkullimit të lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2022 në shtatë prokuroritë themelore dhe në atë speciale.

**Sipas të dhënave të paraqitura në tabelën më lartë, rezulton se normën më të lartë të qarkullimit të lëndëve të korrupsionit në vitin 2022 e ka arritur.**

- **Prokuroria Themelore e Gjilanit**, e cila kishte arritur normën e qarkullimit të lëndëve në 4.53. Kjo prokurori kishte arritur të zgjidh 68 lëndë, përkatësisht 82 % të lëndëve që i kishte në punë, ndërsa vetëm 15 lëndë kanë mbetur të pazgjidhura, të cilat janë bartur në vitin 2023.

**Ndërsa normën më të ulët të qarkullimit të lëndëve e ka arritur:**

- **Prokuroria Themelore e Gjakovës**, e cila kishte arritur normën e qarkullimit të lëndëve në 0.51. Kjo prokurori kishte arritur të zgjidh vetëm 34 lëndë, përkatësisht 34% të lëndëve që i kishte në punë, ndërsa 47 lëndë kishin mbetur të pazgjidhura, të cilat janë bartur në vitin 2023.

Në raport me vitin 2021, sipas matjes së bërë për performancën e sistemit prokurorial në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit, normën më të lartë të qarkullimit të lëndëve e kishte arritur Prokuroria Themelore e Prizrenit (4.29), e cila kishte zgjidhur 73 lëndë, përkatësisht 81 të lëndëve, ndërsa vetëm 8 i kishte bartur për vitin 2022.

Ndërsa normën më të ulët të qarkullimit të lëndëve edhe në vitin 2020 e kishte arritur Prokuroria Themelore e Mitrovicës (0.26), e cila kishte arritur të zgjidh vetëm 28 lëndë, ndërsa 108 lëndë i ka bartur për vitin 2022.

## 3.4 Kohëzgjatja e zgjidhjes së lëndëve (disposition time)

Komisioni Evropian i Efikasitetit të Drejtësisë (CEPEJ) kërkon që sistemi i drejtësisë të raportoj një indikatorë të kohëzgjatjes së përfundimit të lëndëve, që kalkullohet në dy hapa.

Së pari, numri i lëndëve të zgjidhura gjatë periudhës raportuese pjesëtohet me numrin e lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese, që njihet si normë e qarkullimit të lëndëve.<sup>4</sup>

Së dyti, kjo normë e qarkullimit të lëndës pjesëtohet me 365, kështu që indikatori i kohëzgjatjes së zgjidhjes së lëndëve mund të shprehet me numrin e ditëve, për të cilin CEPEJ sugjeron se e thjeshtëzon kuptimin e marrëdhënies mes numrit të lëndëve të zgjedhura gjatë periudhës raportuese dhe numrit të lëndëve që priten të zgjidhen (lëndët e bartura).<sup>5</sup>

Bazuar në normën e qarkullimit të lëndëve, kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve sipas metodologjisë së Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) formulohet në këtë mënyrë:

$$\text{Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve} = \frac{365}{\text{norma e qarkullimit të lëndëve}}$$

Pra numri 365 është numri i ditëve brenda një viti, i cili pjesëtohet me normën e qarkullimit të lëndëve të shtatë prokurorive themelore dhe të asaj speciale, që për vitin 2022 ka rezultuar të jetë 0.82.

Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve që gjatë vitit 2022 kishin mbetur të pazgjidhura në secilën prokurori themelore dhe në atë speciale veç e veç është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

4 [https://www.courtexcellence.com/\\_\\_\\_data/assets/pdf\\_file/0030/54795/GLOBAL-MEASURES-3rd-Edition-Oct-2020.pdf](https://www.courtexcellence.com/___data/assets/pdf_file/0030/54795/GLOBAL-MEASURES-3rd-Edition-Oct-2020.pdf).

5 Po aty.

**PROKURORITË  
THEMELORE TË  
REPUBLIKËS SË  
KOSOVËS DHE  
PROKURORIA SPECIALE**

**Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve** =  $\frac{365}{\text{norma e qarkullimit të lëndëve}}$



**Prokuroria  
Speciale**

$$\frac{365}{0.77} = 474$$



**Prokuroria  
Themelore  
në Prishtinë**

$$\frac{365}{0.62} = 588$$



**Prokurorial  
Themelore  
në Gjilan**

$$\frac{365}{4.53} = 81$$



**Prokuroria  
Themelore  
në Prizren**

$$\frac{365}{1.5} = 243$$



**Prokuroria  
Themelore  
në Mitrovicë**

$$\frac{365}{0.46} = 793$$



**Prokuroria  
Themelore  
në Gjakovë**

$$\frac{365}{0.51} = 716$$



**Prokuroria  
Themelore  
në Pejë**

$$\frac{365}{1.37} = 266$$



**Prokuroria  
Themelore  
në Ferizaj**

$$\frac{365}{0.84} = 435$$



**TABELA 4.**

Kohëzgjatja e zgjidhjes së lëndëve që nuk janë zgjidhur gjatë vitit 2022 në shtatë prokuroritë themelore dhe në atë speciale.

Sipas tabelës së paraqitur më lartë, nëse vazdohet me trendin e njejtë të zgjidhjes së lëndëve sikurse në vitin 2022, rezulton se kohë më e shkurtë për zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit që në këtë viti kishin ngelur të pazgjidhura i duhet:

→ **Prokurorisë Themelore e Gjilanit**, të cilës i duhen mesatarisht edhe 81 ditë për zgjidhjen e të gjitha lëndëve të korrupsionit që në këtë vit kishin mbetur të pazgjidhura. Kjo për shkak se, kjo prokurori ka pasur në punë 83 lëndë të korrupsionit, prej të cilave ka arritur të zgjidh 68 lëndë, dhe vetëm 15 i ka bartur për vitin 2023.

**Ndërsa kohë më e gjatë për zgjidhjen e këtyre lëndëve i duhet:**

→ **Prokurorisë Themelore e Mitrovicës**, të cilës i duhen mesatarisht edhe 793 ditë për zgjidhjen e të gjitha lëndëve të korrupsionit që në këtë vit kishin mbetur të pazgjidhura. Kjo për shkak se, siç u shtjelluar edhe në faqen 21 të këtij raporti, kjo prokurori kishte arritur normën më të ulët të qarkullimit të lëndëve gjatë kësaj periudhe të monitorimit (0.46), prandaj ka rrjedhur ky rezultat.

Ndërkaq sa i përket matjes së këtij indikatori të bërë për vitin 2021 për lëndët e korrupsionit, kohë më e shkurtë për zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit që në këtë vit kishin ngelur të pazgjidhura i është dashur Prokurorisë Themelore të Prizrenit (85 ditë), ndërsa kohë më e gjatë për zgjidhjen e këtyre lëndëve edhe gjatë vitit 2021 i është dashur Prokurorisë Themelore të Mitrovicës (1,403 ditë).



## 3.5 Indeksi i lëndëve të grumbulluara

Një prej problemeve kryesore që raportohet në sistemin e drejtësisë në Kosovë është numri i madh i lëndëve të grumbulluara ndër vite. Prokuroritë, ashtu sikurse gjykatat, vazhdojnë të përballen me lëndë të vjetra që bëhen barrë e ngarkesë e rëndë, e që barten vit pas viti.

Zgjatja e trajtimit të lëndëve dhe numri i madh i lëndëve të bartura bën që të rritet mosbesimi i qytetarëve në institucionet e drejtësisë, pasi ata duhet të presin me vite të tëra që sistemi të merret me lëndët e tyre dhe të ndaj drejtësi për to.

Pra indikator kyç i performancës së prokurorive është edhe indeksi i lëndëve të grumbulluara. Ky indikator determinohet nga numri i lëndëve të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese, në pjesëtim me numrin e lëndëve të zgjidhura gjatë periudhës raportuese.

Indeksi i lëndëve të grumbulluara, përmes metodologjisë së Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë shprehet përmes kësaj formule:

$$\text{Indeksi i lëndëve të grumbulluara} = \frac{\text{lëndët e trashëguara (PS)}}{\text{lëndët e zgjidhura (R)}}$$

Rrjedhimisht sipas kësaj formule, indeksi i lëndëve të grumbulluara të shtatë prokurorive themelore dhe të asaj speciale është :

$$\text{Indeksi i lëndëve të grumbulluara} = \frac{393}{430} = \mathbf{0.91}$$


















Vlera më e lartë e indeksit të lëndëve të grumbulluara tregon se duhet kohë më e gjatë për zgjidhjen e një lënde. Ndërsa në rastin konkret nënkuptohet se prokuroria ka zgjidhur më shumë lëndë se sa ka trashëguar nga viti paraprak.

Ndërkaq në raport me vitin e kaluar (vitin 2021), numri i lëndëve të grumbulluara ka pësuar një ngritje të ndjeshme, meqenëse gjatë vitit 2021 indeksi i lëndëve të grumbulluara ishte 0.77.

Indeksi i lëndëve të grumbulluara në secilën prokurori themelore dhe në atë speciale, është shprehur në tabelën e mëposhtme:

**PROKURORITË THEMELORE  
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
DHE PROKURORIA SPECIALE**

**Indeksi i lëndëve të grumbulluara** =  $\frac{\text{lëndët e trashëguara (PS)}}{\text{lëndët e zgjidhura (R)}}$

	<b>Prokuroria Speciale</b>	$\frac{60}{51} = 1.17$	
	<b>Prokuroria Themelore në Prishtinë</b>	$\frac{117}{122} = 0.95$	
	<b>Prokuroria Themelore në Gjiilan</b>	$\frac{14}{68} = 0.20$	
	<b>Prokuroria Themelore në Prizren</b>	$\frac{17}{51} = 0.33$	
	<b>Prokuroria Themelore në Mitrovicë</b>	$\frac{105}{49} = 2.14$	
	<b>Prokuroria Themelore në Gjakovë</b>	$\frac{36}{24} = 1.5$	
	<b>Prokuroria Themelore në Pejë</b>	$\frac{25}{37} = 0.67$	
	<b>Prokuroria Themelore në Ferizaj</b>	$\frac{19}{28} = 0.67$	
<b>TOTAL:</b>		$\frac{393}{430} = 0.91$	

**TABELA 5.** Indeksi i lëndëve të grumbulluara gjatë vitit 2022 në shtatë prokuroritë themelore dhe në atë speciale.

**Sipas të dhënave të paraqitura në tabelën më lartë, rezulton se indeksin më të ulët të lëndëve të grumbulluara e ka arritur:**

- **Prokuroria Themelore e Gjilanit**, me indeks të lëndëve të grumbulluara në 0.20. Kjo për shkak se, nga 14 lëndë të trashëguara nga viti paraprak dhe 69 lëndë të krijuara gjatë vitit, kjo prokurori kishte arritur të zgjidh 68 prej tyre.

**Ndërsa indeksin më të lartë të lëndëve të grumbulluara e ka arritur:**

- **Prokuroria Themelore e Mitrovicës**, me indeks të lëndëve të grumbulluara në 2.14. Kjo për shkak se, nga 105 lëndë të trashëguara nga viti paraprak dhe 50 lëndë të krijuara gjatë vitit, kjo prokurori kishte arritur të zgjidh vetëm 49 prej tyre.


Ndërkaq sipas matjes së bërë për lëndët e korrupsionit për vitin 2021, gjatë këtij viti indeksin më të ulët të lëndëve të grumbulluara e kishte arritur gjithashtu Prokuroria Themelore e Gjilanit (0.2), ndërsa me indeksin më të lartë të lëndëve të grumbulluara edhe gjatë vitit 2020 e kishte arritur Prokuroria Themelore e Mitrovicës (2.96).

### 3.6 Mënyra e zgjidhjes së lëndëve për persona në shkallën e parë të sistemit prokurorial






Sipas të dhënave të pranuara nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, gjatë vitit 2022 shtatë prokuroritë themelore dhe Prokuroria Speciale kanë zgjidhur lëndët e 826 personave.

Nga të dhënat e disponuara, vërehet se për pjesën më të madhe të personave, apo për 39 %, është hedhur kallëzimi penal. Për 18 %, apo për 146 persona është pushuar hetimi, ndërsa për 32 %, apo për 263 persona janë ngritur aktakuzë. Kurse për 11% të personave, lëndët janë zgjidhur në mënyra të tjera.

Në mënyrë grafike, mënyra e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit për persona në shkallën e parë të sistemit prokurorial si tërësi, është paraqitur në grafikën e mëposhtme.



Ndërkaq mënyra e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit për persona gjatë vitit 2022, për secilën prokurori themelore dhe atë speciale është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

	Është hudhur Kallëzimi penal	Është pushuar hetimi	Është ngritur aktakuzë (e drejtëpërdrejtë, pas zhvillimit të hetimeve, aktakuzë për dhënien e urdhërit ndëshkimor)	Është zgjidhur në mënyrë tjetër (është bashkuar procedura)
 Prokuroria Speciale	71	22	54	34
 Prokuroria Themelore në Prishtinë	78	36	99	1
 Prokuroria Themelore në Prizren	33	15	3	25
 Prokuroria Themelore në Pejë	49	5	1	32
 Prokuroria Themelore në Gjilan	37	26	36	0
 Prokuroria Themelore në Mitrovicë	28	23	38	0
 Prokuroria Themelore në Ferizaj	15	14	21	0
 Prokuroria Themelore në Gjakovë	13	5	11	1

**TABELA 6.** Mënyra e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2022 për persona në të gjitha prokuroritë themelore veç e veç, si dhe në atë speciale.

**Ndryshe nga viti 2021, ku shkalla e parë e sistemit prokurorial kishte ngritur aktakuza për veprat penale të korrupsionit për 335 persona, ky numër në vitin 2022 kishte shënuar ulje për 21 %.**

# 4

**Performanca e  
sistemit gjyqësor në  
zgjidhjen e lëndëve  
të korrupsionit gjatë  
vitit 2022**








## 4. Performanca e sistemit gjyqësor në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2022

Puna dhe vendosmëria e gjykatave të Republikës së Kosovës në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit mund të vërehet në të dhënat periodike të cilat përmbajnë të dhëna që nga pranimi i rasteve dhe deri të zgjidhja përfundimtare e tyre. Këto të dhëna duhet të përpunohen në pajtim me metodologjinë adekuate, në mënyrë që të krijojmë pasqyrën e përgjithshme të përmbushjes së misionit të sistemit gjyqësor mbi këtë fushë specifike. Rezultati i dalur nga një përpunim i tillë do të jetë tregues i qartë i nivelit të zgjidhjes së lëndëve dhe indikatorëve të tjerë në fushën e korrupsionit.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur aasqyra e përgjithshme me të dhënat e sistemit gjyqësor, në të cilët janë bazuar këta indikatorë.

Ndërsa në vijim janë paraqitur rezultatet nga indikatorët matës të efikasitetit të punës së Gjykatave të Republikës së Kosovës në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2022, sipas metodologjisë së Komisionit Evropian për Matjen e Efikasitetit të Drejtësisë (CEPEJ).



	PS Lëndë të trashëguara	I Lëndë të reja	LP Gjithsej lëndë në punë
 Gjykata Themelore në Prishtinë	74	36	110
 Gjykata Themelore në Gjiilan	21	27	48
 Gjykata Themelore në Prizren	13	20	33
 Gjykata Themelore në Mitrovicë	31	14	45
 Gjykata Themelore në Gjakovë	5	3	8
 Gjykata Themelore në Pejë	4	8	12
 Gjykata Themelore në Ferizaj	10	2	12

TOTAL:

158

110

268

R PE  
Lëndë të zgjidhura Lëndë të pazgjidhura

33 77

17 31

15 18

6 37


3 5

6 6

2 10

82

184



## 4.1 Fluksi i lëndëve


Siç është shtejlluar edhe në pjesën e parë të këtij raporti, fluksi i lëndëve është tregues i ngarkesës së sistemit më lëndë në punë dhe përfshin lëndët e reja të krijuara gjatë vitit dhe lëndët trashëguara, respektivisht të bartura nga viti paraprak.

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2022, gjithsej raste në punë në shtatë gjykatat themelore të Republikës së Kosovës në lidhje me veprat penale të korrupsionit kanë qenë 268 lëndë.

Në këtë numër, pra, kanë kontribuar lëndët e bartura nga viti paraprak (158 lëndë), si dhe lëndët e reja të krijuara gjatë vitit (110 lëndë). Shprehur në përqindje, 59 % e lëndëve të korrupsionit të të gjitha gjykatave që ishin në punë gjatë vitit 2022 ishin të bartura nga viti paraprak, ndërsa 41 % e lëndëve ishin lëndë të reja, të krijuar gjatë vitit 2022.



Ndërkaq në grafikën e mëposhtme është shfaqur renditja e gjykatave sipas fluksit të lëndëve të korrupsionit.



**FIGURA 5.** Renditja e gjykatave sipas fluksit të lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2022.

**Nga tabela e vendosur më sipër, shihet se me fluksin më të madh të lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2022 ishte përballur:**

→ **Gjykata Themelore e Prishtinës**, e cila në punë kishte gjithsej 110 lëndë të korrupsionit, 74 prej të cilave ishin trashëguar nga viti paraprak, ndërsa 36 lëndë ishin krijuar gjatë vitit 2022.

**Ndërsa me fluksin më të ulët të lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2022 ishte përballur:**

→ **Gjykata Themelore e Gjakovës**, e cila në punë kishte gjithsej 8 lëndë të korrupsionit, 5 prej të cilave ishin trashëguar nga viti paraprak, ndërsa 3 lëndë ishin krijuar gjatë vitit 2022.

Ndërkaq në krahasim me vitin 2021, gjykatat themelore kishin në punë gjithsej 383 lëndë të korrupsionit. Gjykata me fluksin më të lartë të lëndëve ishte, po ashtu, Gjykata Themelore e Prishtinës, me 197 lëndë në punë. Ndërsa me fluksin më të ulët ishte përballur Gjykata Themelore e Gjakovës, me gjithsej 15 lëndë të korrupsionit në punë.

## 4.2 Norma e zgjidhjes së lëndëve (clearance rate)

Norma e zgjidhjes së lëndëve është një indikator i rëndësishëm që tregon performancën e gjykatave në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit të shprehur në përqindje, si dhe tregon për kapacitetin punues të gjykatave. Në këtë normë nuk përfshihen numri i lëndëve të trasheguara, por vetëm numri i lëndëve të reja, të krijuara gjatë vitit.

Ashtu siç u shpjegua në pjesën e parë, norma e zgjidhjes së lëndëve sipas metodologjisë së Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) shprehet përmes kësaj formule:

$$\text{Norma e zgjidhjes së lëndëve \%} = \frac{\text{lëndët e zgjidhura (R)}}{\text{lëndët e reja (I)}} \times 100$$

Rrjedhimisht sipas kësaj formule, norma mesatare e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit në vitin 2022 në të gjitha gjykatat themelore të Republikës së Kosovës ishte:

$$\text{Norma e zgjidhjes së lëndëve \%} = \frac{82}{110} \times 100 = \mathbf{75\%}$$
















Sipas kësaj formule, ku numri i lëndëve të korrupsionit të zgjidhura gjatë vitit 2022 ishte 82 lëndë, ndërsa numri i lëndëve të reja të krijuara gjatë vitit ishte 110 lëndë, norma e lëndëve të zgjidhura gjatë vitit 2022 rezulton të jetë 75 %.

Pra shkalla e parë e sistemit gjyqësor në vitin 2022 ka arritur të zgjidh 18 lëndë më pak se sa ka pranuar, prandaj kjo është reflektuar edhe në normën e ulët të zgjidhjes së lëndëve.

Në tabelën e mëposhtme është shfaqur norma e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit në secilën prej gjykatave themelore të Republikës së Kosovës.

**GJYKATAT THEMELORE TË  
REPUBLICËS SË KOSOVËS**

$$\text{Norma e zgjidhjes së lëndëve \%} = \frac{\text{lëndët e zgjidhura (R)}}{\text{lëndët e reja (I)}} \times 100$$

	Gjykata Themelore në Prishtinë	$\frac{33}{36} \times 100 =$	<b>92%</b>	
	Gjykata Themelore në Gjilan	$\frac{17}{27} \times 100 =$	<b>63%</b>	
	Gjykata Themelore në Prizren	$\frac{15}{20} \times 100 =$	<b>75%</b>	
	Gjykata Themelore në Mitrovicë	$\frac{6}{14} \times 100 =$	<b>43%</b>	
	Gjykata Themelore në Gjakovë	$\frac{3}{3} \times 100 =$	<b>100%</b>	
	Gjykata Themelore në Pejë	$\frac{6}{8} \times 100 =$	<b>75%</b>	
	Gjykata Themelore në Ferizaj	$\frac{2}{2} \times 100 =$	<b>100%</b>	
<b>TOTAL:</b>		$\frac{82}{110} \times 100 =$	<b>75%</b>	

**TABELA 8.** Norma e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit në të gjitha gjykatat themelore të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2022.

Nga kjo tabelë, shihet se normën më të lartë të zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit në vitin 2022 e ka arritur:

- **Gjykata Themelore e Gjakovës** e cila kishte 3 lëndë të reja të krijuara gjatë vitit, ndërsa kishte arritur të zgjidh 3 lëndë, duke arritur normën e zgjidhjes së lëndëve në 100 %; si dhe **Gjykata Themelore e Ferizajt**, e cila kishte 2 lëndë të krijuara gjatë vitit dhe kishte arritur të zgjidh 2 lëndë, duke arritur normë të zgjidhjes së lëndëve në 100%.

Ndërsa normën më të ulët të zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit e kishte arritur:

- **Gjykata Themelore e Mitrovicës**, e cila kishte 14 lëndë të reja të krijuara gjatë vitit, ndërsa kishte arritur të zgjidh 6 lëndë, duke arritur normën e zgjidhjes së lëndëve në 43%.

Ndërsa në vitin 2021, shtatë gjykatat themelore kishin arritur normë të zgjidhjes së lëndëve dukshëm më të lartë, përkatësisht 108%.

Gjykata me normën më të ulët të zgjidhjes së lëndëve në vitin 2021 ishte Gjykata Themelore e Gjilanit, e cila kishte arritur normë të zgjidhjes së lëndëve në 156 %, ndërsa gjykata me normën më të ulët të zgjidhjes së lëndëve ishte Gjykata Themelore e Mitrovicës, e cila kishte arritur normë të zgjidhjes së lëndëve në 79%.

## 4.3 Norma e qarkullimit të lëndëve (case turnover ratio)

Siç është shtjelluar edhe në pjesën e parë të raportit, norma e qarkullimit të lëndëve mat raportin mes numrit të lëndëve të zgjidhura dhe numrit të lëndëve të pazgjidhura. Pra kjo normë e mat frekuencën me të cilën sistemi gjyqësor e zëvendëson numrin e lëndëve të reja. Me fjalë të tjera, norma qarkullimit të lëndëve mat se sa shpejt sistemi (në këtë rast sistemi gjyqësor) i trajton lëndët që i pranon – që ndryshe i bie se sa shumë kohë merr sistemi për zgjedhjen e një lënde.

Norma mesatare e qarkullimit të lëndëve të korrupsionit në vitin 2022 në të gjitha gjykatat themelore të Republikës së Kosovës ishte:

$$\text{Norma e qarkullimit të lëndëve} = \frac{82}{104} \times 100 = \mathbf{0.44}$$

Norma ideale e qarkullimit të lëndëve do të duhej të ishte të paktën 1, që nënkupton se sistemi zgjidh po aq lëndë sa pranon gjatë vitit dhe nuk ka bartur asnjë lëndë për vitin e ardhshëm.
















Ndërsa në rastin konkret, sistemi gjyqësor ka arritur të zgjidh vetëm 82 lëndë, përkatësisht vetëm 31% të të gjitha lëndëve që i ka pasur në punë, ndërsa 184 lëndë, apo 69% nuk ka arritur t'i zgjidh dhe i ka bartur në vitin 2023, prandaj e ka arritur këtë normë të qarkullimit të lëndëve.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur norma e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit në secilën prej gjykatave themelore të Republikës së Kosovës.



**GJYKATAT THEMELORE TË  
REPUBLICËS SË KOSOVËS**

$$\text{Norma e qarkullimit të lëndëve} = \frac{\text{lëndët e zgjidhura (R)}}{\text{lëndët pa zgjidhura (PE)}}$$

	Gjykata Themelore në Prishtinë	$\frac{33}{77} = 0.42$	
	Gjykata Themelore në Gjilan	$\frac{17}{31} = 0.54$	
	Gjykata Themelore në Prizren	$\frac{15}{18} = 0.83$	
	Gjykata Themelore në Mitrovicë	$\frac{6}{37} = 0.16$	
	Gjykata Themelore në Gjakovë	$\frac{3}{5} = 0.6$	
	Gjykata Themelore në Pejë	$\frac{6}{6} = 1$	
	Gjykata Themelore në Ferizaj	$\frac{2}{10} = 0.2$	
<b>TOTAL:</b>		$\frac{82}{104} = 0.44$	

**TABELA 9.**

Norma e qarkullimit të lëndëve të korrupsionit në të gjitha gjykatat themelore të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2022.

**Nga kjo tabelë, shihet se normën më të qarkullimit të lëndëve të korrupsionit në vitin 2022 e ka arritur:**

- **Gjykata Themelore e Pejës**, e cila këtë vit kishte arritur normën e qarkullimit të lëndëve në 1. Kjo gjykatë kishte arritur të zgjidh 6 lëndë, ndërsa 6 lëndë kanë mbetur të pazgjidhura dhe janë bartur në vitin 2023.

**Ndërsa normën më të ulët të qarkullimit të lëndëve të korrupsionit e ka arritur:**

- **Gjykata Themelore e Mitrovicës**, e cila këtë vit kishte arritur normën e qarkullimit të lëndëve në 0.16. Kjo gjykatë kishte arritur të zgjidh 6 lëndë, ndërsa edhe 37 lëndë kanë mbetur të pazgjidhura dhe janë bartur në vitin 2023.

Ndërkaq në vitin 2021, shtatë gjykatat themelore e kishin arritur normën e qarkullimit të lëndëve në 0.39. Gjykata me normën më të lartë të qarkullimit të lëndëve ishte Gjykata Themelore e Prizrenit (1.15), ndërsa gjykata me normën më të ulët ishte Gjykata Themelore e Prishtinës me normë të Qarkullimit 0.20.

## 4.4 Kohëzgjatja e zgjidhjes së lëndëve (disposition time)

Siç është theksuar edhe në pjesën e parë të raportit, kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve sipas metodologjisë së Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) formulohet në këtë mënyrë:















$$\text{Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve} = \frac{365}{\text{norma e qarkullimit të lëndëve}}$$

Pra numri 365 është numri i ditëve brenda periudhës raportuese, që pjesëtohet me normën e qarkullimit të lëndëve të shtatë gjykatave themelore, që këtë vit ka rezultuar 0.44..

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur norma e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit në secilën prej gjykatave themelore të Republikës së Kosovës.

## GJYKATAT THEMELORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve =  $\frac{365}{\text{norma e qarkullimit të lëndëve}}$

	Gjykata Themelore në Prishtinë	$\frac{365}{0.42} = 869$	
	Gjykata Themelore në Gjilan	$\frac{365}{0.54} = 676$	
	Gjykata Themelore në Prizren	$\frac{365}{0.83} = 440$	
	Gjykata Themelore në Mitrovicë	$\frac{365}{0.16} = 2,281$	
	Gjykata Themelore në Gjakovë	$\frac{365}{0.6} = 608$	
	Gjykata Themelore në Pejë	$\frac{365}{1} = 365$	
	Gjykata Themelore në Ferizaj	$\frac{365}{0.2} = 1,825$	

**TABELA 10.**

Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve të korrupsionit në të gjitha gjykatat themelore të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2022.

Sipas tabelës së paraqitur më lartë, nëse vazhdohet me trendin e njejtë të zgjidhjes së lëndëve, rezulton se kohë më e shkurtë për zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit që në këtë viti kishin ngelur të pazgjidhura i duhet:

→ **Gjykatës Themelore të Pejës**, të cilës i duhen mesatarisht edhe 365 ditë për zgjidhjen e të gjitha lëndëve të korrupsionit që në këtë vit kishin mbetur të pazgjidhura. Kjo për shkak se kjo gjykatë kishte arritur normën më të lartë të qarkullimit të lëndëve gjatë kësaj periudhe të monitorimit (1).

Ndërsa, nëse vazhdohet me trendin e njejtë të zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit, kohë më e gjatë për zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit i duhet:

→ **Gjykatës Themelore të Mitrovicës**, të cilës i duhen mesatarisht edhe 2,281 ditë për zgjidhjen e të gjitha lëndëve të korrupsionit që në këtë vit kishin mbetur të pazgjidhura. Kjo për shkak se kjo gjykatë kishte arritur normën më të shkurtë të qarkullimit të lëndëve gjatë kësaj periudhe të monitorimit (0.20).

Ndërsa në vitin 2021, gjykatës që i duheshin më së shumti ditë në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit ishte Gjykata Themelore e Prishtinës, të cilës i duheshin edhe 2,825 për të zgjidhur lëndët e korrupsionit që kishin mbetur të pazgjidhura në vitin paraprak. Ndërsa gjykatës të cilës i duheshin më pak ditë për zgjidhjen e këtyre lëndëve ishte Gjykata Themelore e Prizrenit, të cilës i duheshin edhe 317 ditë për të zgjidhur lëndët e korrupsionit që kishin mbetur të pazgjidhura në atë periudhë.

## 4.5 Indeksi i lëndëve të grumbulluara

Siç është shtjelluar edhe në pjesën e parë të raportit, Indeksi i lëndëve të grumbulluara, përmes metodologjisë së Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë shprehet përmes kësaj formule:

$$\text{Indeksi i lëndëve të grumbulluara} = \frac{\text{lëndët e trashëguara (PS)}}{\text{lëndët e zgjidhura (R)}}$$
















Rrjedhimisht sipas kësaj formule, indeksi mesatar i lëndëve të grumbulluara në të gjitha gjykatat themelore gjatë vitit 2022 është:

$$\text{Indeksi i lëndëve të grumbulluara} = \frac{158}{82} \times 100 = \mathbf{1.92}$$

Sa më e lartë të jetë vlera e këtij indikator, aq më gjatë i nevojitet kohë sistemit për zgjidhjen e lëndëve. Në rastin konkret, numri i lëndëve të trashëguara nga viti paraprak ishte dukshëm më i lartë se sa numri i lëndëve që ka mundur të zgjidh sistemi gjatë këtij viti, prandaj është reflektuar në indeksin e lartë të lëndëve të grumbulluara.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur indeksi mesatar i lëndëve të korrupsionit të grumbulluara në secilën prej gjykatave themelore të Republikës së Kosovës.

**GJYKATAT THEMELORE TË  
REPUBLICËS SË KOSOVËS**
**Indeksi i lëndëve të grumbulluara** =  $\frac{\text{lëndët e trashëguara (PS)}}{\text{lëndët e zgjidhura (R)}}$ 

	<b>Gjykata Themelore në Prishtinë</b>	$\frac{74}{33} = 2.24$	
	<b>Gjykata Themelore në Gjilan</b>	$\frac{21}{17} = 1.23$	
	<b>Gjykata Themelore në Prizren</b>	$\frac{13}{15} = 0.86$	
	<b>Gjykata Themelore në Mitrovicë</b>	$\frac{31}{6} = 5.16$	
	<b>Gjykata Themelore në Gjakovë</b>	$\frac{5}{3} = 1.6$	
	<b>Gjykata Themelore në Pejë</b>	$\frac{4}{6} = 0.66$	
	<b>Gjykata Themelore në Ferizaj</b>	$\frac{10}{2} = 5$	
<b>TOTAL:</b>		$\frac{158}{82} = 1.92$	

**TABELA 11.**

Indeksi i lëndëve të grumbulluara në të gjitha gjykatat themelore të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2022.

**Sipas të dhënave të paraqitura në tabelën më lartë, rezulton se indeksin më të ulët të lëndëve të grumbulluara gjatë vitit 2022 e ka arritur:**

- **Gjykata Themelore e Mitrovicës**, me indeks të lëndëve të grumbulluara në 5.16. Kjo për shkak se, nga 31 lëndë të trashëguara nga viti paraprak dhe 14 lëndë të krijuara gjatë vitit, kjo gjykatë kishte arritur të zgjidh vetëm 6 prej tyre, ndërsa 37 i ka bartur për vitin 2023.

**Ndërsa me indeksin më të lartë të lëndëve të grumbulluara gjatë vitit 2022 e ka arritur:**


- **Gjykata Themelore e Pejës**, me indeks të lëndëve të grumbulluara në 0.66. Kjo për shkak se, nga 4 lëndë të trashëguara nga viti paraprak dhe 8 lëndë të krijuara gjatë vitit, kjo gjykatë kishte arritur të zgjidh vetëm 6 prej tyre dhe 6 i ka bartur për vitin e 2023.

Ndërsa në vitin 2021, gjykata me indeksin më të lartë të lëndëve të grumbulluara ishte Gjykata Themelore e Prizrenit (2.96). Ndërsa gjykata me indeksin më të ulët të lëndëve të grumbulluara ishte Gjykata Themelore e Gjilanit (0.20).










## 4.6 Mënyra e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit nga shkalla e parë e sistemit gjyqësor

Sa i përket mënyrës së zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit nga të gjitha gjykatat themelore të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2022, nga 82 lëndët e zgjidhura gjatë këtij viti, janë nxjerrë 41 aktgjykime fajësuese (50 %), 23 aktgjykime liruese (28%), 4 aktgjykime refuzuese (5%), si dhe 14 lëndë janë zgjidhur në mënyrë tjetër (17%).










Në tabelën e mëposhtme është paraqitur mënyra e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2022 në secilën prej gjykatave themelore të Republikës së Kosovës.

	Aktgjykim fajësues	Aktgjykim lirues	Aktgjykim refuzues	Janë zgjidhur në mënyra tjera
 Gjkata Themelore në Prishtinë	15	12	2	3
 Gjkata Themelore në Prizren	9	3	0	4
 Gjkata Themelore në Pejë	5	1	0	0
 Gjkata Themelore në Gjilan	6	3	1	7
 Gjkata Themelore në Mitrovicë	3	2	1	0
 Gjkata Themelore në Ferizaj	2	0	0	0
 Gjkata Themelore në Gjakovë	1	2	0	0

**TABELA 12.**

Mënyra e zgjidhjes së lëndëve në të gjitha gjykatat themelore të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2022.


Ndërkaq llojet e dënimeve të shqiptuara për veprat penale të korrupsionit në secilën prej këtyre gjykatave për vitin 2022, është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

	Dënime me burgim	Dënime me kusht	Dënime me gjobë	Dënimi plotësues: Ndalimi i ushtrimit të funksioneve publike
 Gjkata Themelore në Prishtinë	24	6	8	5
 Gjkata Themelore në Prizren	2	6	8	0
 Gjkata Themelore në Pejë	3	3	5	0
 Gjkata Themelore në Gjilan	4	2	5	0
 Gjkata Themelore në Mitrovicë	0	4	2	0
 Gjkata Themelore në Ferizaj	9	0	2	0
 Gjkata Themelore në Gjakovë	0	1	1	0

**TABELA 13.**

Llojet e dënimeve të shqiptuara nga secila prej gjykatave themelore të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2022 në lidhje me veprat penale të korrupsionit.

Në figurën e mëposhtme është paraqitur në mënyrë grafike lloji i dënimeve të shqiptuara në tërësi nga gjykatat themelore të Republikës së Kosovës në lidhje me lëndët e korrupsionit gjatë vitit 2022.



Pra në tabelën e mësipërme shihet se nga aktgjykimet fajësuese të shqiptuara gjatë kësaj periudhe, 42 persona janë dënuar më burgim, 22 persona janë dënuar me kusht, 31 persona janë dënuar me gjobë, ndërsa për 5 persona është shqiptuar dënimi plotësues: ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike.

## 5. Konkluzion

Në bazë të të dhënave që i kemi siguruar dhe projektimit të tyre në bazë të metodologjisë së Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), në këtë pjesë do të përshkruajmë disa nga gjetjet kryesore të këtij raporti.

### Gjetjet kryesore në lidhje me performancën e shkallës së parë të sistemit prokurorial në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit janë:

- Shkalla e parë e sistemit prokurorial të Kosovës gjatë vitit 2022 ka pasur në punë gjithsej 953 lëndë të korrupsionit, numër ky që në raport me vitin 2021 (802 lëndë në punë) ishte rritur për 19 %. Prej ketyre lëndëve të korrupsionit në punë, 393 prej tyre (41 %) kanë qenë të bartura nga vitet paraprake, ndërsa 560 lëndë (59%) kanë qenë lëndë të reja të krijuara gjatë vitit.
- Nga të gjitha lëndët e korrupsionit në punë, shkalla e parë ka arritur të zgjidh 430 lëndë, apo vetëm 45 % të të gjitha lëndëve që i ka pasur në punë gjatë vitit 2022. Ndërsa pjesa tjetër prej 523 lëndëve, apo 55 % të tyre, kanë mbetur të pazgjidhura dhe janë bartur për vitin 2023. Këto shifra tregojnë për ulje të nivelit të zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit nga këto institucione, në krahasim me vitin 2021, ku këto insitucione kishin zgjidhur 51 % të lëndëve të korrupsionit që i kanë pasur në punë.
- Shkalla e parë e sistemit prokurorial gjatë vitit 2022 ka ngritur aktakuza për 263 persona (aktakuza të drejtpërdrejta dhe aktakuza pas hetimeve). Ky numër i akatakuzave për persona kishte përsuar rënje në krahasim me vitin 2021, ku ishin akuzuar 335 persona për veprat penale të korrupsionit. Ndërkaq kallëzimet penale të 324 personave ishin hedhur, ndërsa për 146 persona është pushuar hetimi.
- Norma mesatare e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit gjatë kësaj periudhe ka rezultuar të jetë 77 %, normë kjo që merr parasysh vetëm numrin e lëndëve të zgjidhura gjatë kësaj periudhe (430 lëndë) dhe numrin e lënvë të reja të krijuara gjatë vitit (560 lëndë). Pra numri i lëndëve të zgjidhura gjatë kësaj periudhe është dukshëm më ulët se numri i lëndëve të reja të krijuara gjatë vitit, prandaj është reflektuar edhe në këtë normë të ulët të zgjidhjes së lëndëve.
- Norma mesatare e qarkullimit të lëndëve të korrupsionit në shkallën e parë të sistemit prokurorial gjatë kësaj periudhe ka rezultuar të jetë 0.82. Kjo normë merr parasysh vetëm proporcionin midis lëndëve të zgjidhura gjatë kësaj periudhe (430 lëndë) dhe lëndëve të pazgjidhura (523 lëndë).

- Indeksi mesatar i lëndëve të grumbulluara të korrupsionit në shkallën e parë të sistemit prokurorial gjatë vitit 2022 është arritur 0.91. Kjo ka arritur si pasojë e faktit se numri i lëndëve të korrupsionit të trashëguara nga periudhat paraprahe është më i ulët (393 lëndë) se numri i lëndëve të zgjidhura gjatë kësaj periudhe (430 lëndë).
- Nga pasqyra e përgjithshme e statistikave të pranuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, si dhe bazuar në rezultatet e matjes së indikatorëve të Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), shihet se prokuroria që ka arritur rezultatet më të mira në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit (në aspekt kuantitativ) është Prokuroria Themelore e Gjilanit. Nga 83 lëndë të korrupsionit sa ka pasur në punë, kjo prokurori ka arritur të zgjidh 68 lëndë, apo 82% të të gjitha lëndëve që i ka pasur në punë. Me këto shifra, kjo prokurori ka arritur normën më të lartë të zgjidhjes së lëndëve (99%), normën më të lartë të qarkullimit të lëndëve (4.53), kohën më të shkurtër të nevojshme për zgjidhjen e lëndëve që në këtë vit kishin mbetur të pazgjidhura (81 ditë), si dhe indeksin më të ulët të lëndëve të grumbulluara (0.20).
- Ndërkaq prokuroria që ka arritur rezultatet më të dobëta në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit (në aspektin kuantitativ), bazuar në statistikave të Komisionit Evropian të Kosovës, është Prokuroria Themelore e Mitrovicës, e cila nga 155 lëndë të korrupsionit sa ka pasur në punë, ka arritur të zgjidh 49 lëndë, apo 32 % të të gjitha lëndëve. Me këto shifra, kjo prokurori ka arritur normën më të ulët të qarkullimit të lëndëve (0.46), kohën më të gjatë të nevojshme për zgjidhjen e të gjitha lëndëve që këtë vit kishin mbetur të pazgjidhura (793 ditë), si dhe indeksin më të lartë të lëndëve të grumbulluara (2.14).

### **Gjetjet kryesore në lidhje me performancën e shkallës së parë të sistemit gjyqësor të Kosovës në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit janë:**

- Shkalla e parë e sistemit gjyqësor të Kosovës gjatë vitit 2022 ka pasur në punë gjithsej 268 lëndë të korrupsionit, numër ky që në raport me vitin 2021 (383 lëndë në punë) ishte zvogëluar për 20 %. Prej ketyre lëndëve të korrupsionit në punë, 158 prej tyre (59 %) kanë qenë të bartura nga vitet paraprahe, ndërsa 110 lëndë (41%) kanë qenë lëndë të reja të krijuara gjatë vitit.
- Nga të gjitha lëndët e korrupsionit në punë, shkalla e parë e sistemit gjyqësor ka arritur të zgjidh 81 lëndë, apo vetëm 31 % të të gjitha lëndëve që i ka pasur në punë gjatë vitit 2022. Ndërsa pjesa tjetër prej 184 lëndëve, apo 69 % të tyre, kanë mbetur të pazgjidhura dhe janë bartur për vitin 2023. Këto shifra tregojnë për ulje të nivelit të zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit nga këto institucione, në krahasim me vitin 2021, ku këto institucione kishin zgjidhur 38 % të lëndëve të korrupsionit që i kanë pasur në punë.
- Nga 82 lëndët e zgjidhura gjatë këtij viti, janë nxjerrë 41 aktgjykime fajësuese (50 %), 23 aktgjykime liruese (28%), 4 aktgjykime refuzuese (5%), si dhe 14 lëndë janë zgjidhur në mënyrë tjetër (17%).
- Nga aktgjykimet fajësuese, 42 persona janë dënuar me burgim, 22 persona janë dënuar me kusht, 31 persona janë dënuar me gjobë, ndërsa për 5 persona është shqiptuar dënimi plotësues: ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike.

- Norma mesatare e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit gjatë kësaj periudhe ka rezultuar të jetë 75 %, normë kjo që merr parasysh vetëm numrin e lëndëve të zgjidhura gjatë kësaj periudhe (82 lëndë) dhe numrin e lëndëve të reja të krijuara gjatë vitit (110 lëndë). Pra numri i lëndëve të zgjidhura gjatë kësaj periudhe ishte dukshëm më ulët se numri i lëndëve të reja të krijuara gjatë vitit, prandaj është reflektuar edhe në këtë normë të ulët të zgjidhjes së lëndëve.
- Norma mesatare e qarkullimit të lëndëve të korrupsionit në shkallën e parë të sistemit gjyqësor gjatë kësaj periudhe ka rezultuar të jetë 0.44. Kjo normë merr parasysh vetëm proporcionin midis lëndëve të zgjidhura gjatë kësaj periudhe (82 lëndë) dhe lëndëve të pazgjidhura (184 lëndë).
- Indeksi mesatar i lëndëve të grumbulluara të korrupsionit në shkallën e parë të sistemit gjyqësor gjatë vitit 2022 është arritur 1.92. Kjo ka arritur si pasojë e faktit se numri i lëndëve të korrupsionit të trashëguara nga periudhat paraprake (158 lëndë) është shumë më i lartë se numri i lëndëve të zgjidhura gjatë kësaj periudhe (82 lëndë).
- Nga pasqyra e përgjithshme e statistikave të pranuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, si dhe bazuar në rezultatet e matjes së indikatorëve të Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), shihet se gjykata që ka arritur rezultatet më të mira në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit gjatë vitit 2022 (në aspekt kuantitativ) është Gjykata Themelore e Pejës. Nga 12 lëndë të korrupsionit sa ka pasur në punë, kjo gjykatë ka arritur të zgjidh 6 lëndë, apo 50 % të të gjitha lëndëve që i ka pasur në punë. Me këto shifra, kjo gjykatë ka arritur normën më të lartë të qarkullimit të lëndëve (1), kohën më të shkurtër të nevojshme për zgjidhjen e lëndëve që në këtë vit kishin mbetur të pazgjidhura (365 ditë), si dhe indeksin më të ulët të lëndëve të grumbulluara (0.66).
- Ndërkaq gjykata që ka arritur rezultatet më të dobëta në zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit (në aspektin kuantitativ), bazuar në statistikën e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, është Gjykata Themelore e Mitrovicës, e cila nga 45 lëndë të korrupsionit sa ka pasur në punë, ka arritur të zgjidh vetëm 6 lëndë, apo 13 % të të gjitha lëndëve. Me këto shifra, kjo prokurori ka arritur normën më të ulët të zgjidhjes së lëndëve (43%), normën më të ulët të qarkullimit të lëndëve (0.43), kohën më të gjatë të nevojshme për zgjidhjen e të gjitha lëndëve që këtë vit kishin mbetur të pazgjidhura (2,281 ditë), si dhe indeksin më të lartë të lëndëve të grumbulluara (5.16).

## 6. Rekomandime

Duke marrë parasysh qëllimin e përpilimit të këtij raporti, gjatë rrugës së përpunimit të të dhënave dhe gjetjes së rezultateve në bazë të një metodologjie paraprakisht të përcaktuar, kanë derivuar disa pikëpamje mbi objektin e hulumtimit.

Gjetjet e këtij raporti përveç që paraqesin pasqyrën e punës së prokurorive dhe gjykatave, ato paraqesin tregues të qartë të zhvillimit, përmirësimit dhe ngritjes së efikasitetit.

Prandaj, duke bërë ndërlidhjen në mes të konkluzioneve të këtij raporti dhe intencës për ngritje të efikasitetit të punës së Prokurorit të Shtetit dhe të sistemit gjyqësor, Lëvizja FOL jep këto rekomandime:

- ▶ Të rritet numri i prokurorëve dhe gjyqtarëve në departamentet përkatëse për krime të rënda, që merren me rastet e korrupsionit;
- ▶ Lëndët e korrupsionit, e veçanërisht ato të profilit të lartë, të trajtohen me prioritet absolut nga institucioneve të sistemit të drejtësisë;
- ▶ Të respektohen në përpikmëri obligimet në trajtimin e rasteve të korrupsionit sipas afateve dhe obligimeve të përcaktuara në ligj;
- ▶ Të rritet bashkëpunimi ndër-institucional, si një premisë bazë për suksesin e veprimtarisë së sistemit të drejtësisë në luftimin e suksesshëm të korrupsionit;
- ▶ Të publikohen në vazhdimësi raportet statistikore në ueb-faqen zyrtare të sistemit prokurorial dhe të atij gjyqësor në lidhje me fluksin e lëndëve të korrupsionit dhe numrin e lëndëve të zgjidhura dhe në përgjithësi për trajtimin e rasteve të korrupsionit.



FOL

